

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“VIP HEALTH INTERNATIONAL” SHPK.**

Sot, në Tiranë, më 30.08.2022, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **“VIP HEALTH INTERNATIONAL” SHPK.**

Unë ortaku i vetëm Elisabeta ILNICA, e bija e Ramazanit, e datëlindjës 11.04.1980, lindur në Dibër dhe banuese në Tiranë në adresën: Hysen Bastari; Nd. 3; H. 2; Dajt; Linzë; TIRANË, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal I05411119I, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare “VIP HEALTH INTERNATIONAL” SHPK, e cila do ti nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISË**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare “VIP HEALTH INTERNATIONAL” SHPK do të jetë në adresën: Rruga Hysen Bastari; Nd. 3; H. 2; Dajt; Linzë; TIRANË

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt: **Sherbime ne fushen wellnes: testet e intolerances ushqimore, dieta, sherbime nutricionit & dietike, konsulta wellnes,**

**Ofrimi dhe ndermjetesimi per zhvillimin e turizmit wellness & shendetesor, historik dhe kulturor. Te zhvilloje fushata marketingu, mirembajtje dhe menaxhim te rrjeteve sociale, si dhe konsulenca sipas nevojës privat-shtet.**

**Import eksport i mallrave e produkteve te ndryshem e kryesisht te pajisjeve mjekesore. Shoqeria gjithashtu mund te kryeje te gjitha aktivitetet e tjera te cilat jane te lejuara sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar ne fuqi**

**Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes të mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

*Elisabeta Ilnica*

## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lek (Njëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

## DREJTIMI I SHOQËRISË

### Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "VIP HEALTH INTERNATIONAL" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj zj. Elisabeta ILNICA për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

### Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

### Neni 10

Shoqëria tregtare "VIP HEALTH INTERNATIONAL" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

### Neni 11

Shoqëria tregtare "VIP HEALTH INTERNATIONAL" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar si më poshtë.

## THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"VIP HEALTH INTERNATIONAL" SHPK

ORTAKU I VETËM

Elisabeta ILNICA

*Elisabeta Ilnica*

